

VENDIM
Nr. 452, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTEVE “RIKONSTRUKSION I RRUGËS VOSKOPOJË–SHËN PRODHOM” DHE “PARKU JAPONEZ DHE KOPSHTET E KOMUNITETIT”, BASHKIA KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve “Rikonstruksion i rrugës Voskopoje–Shën Prodhom” dhe “Parku japonez dhe kopshtet e komunitetit”, në Bashkinë e Korçës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë arë” dhe “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 831 945 (një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 831 945 (një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Korçë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Korçë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Korçë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Korçë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS VOSKOPOJË–SHËN PRODHOM”, BASHKIA KORÇË

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Zona kadastrale	I regjistruar pranë ZVRPP-së me nr.	Statusi i pronës sipas ZVRPP-së	Sipërfaqja e cila shpronësohet (m ²)	Çmimi lekë/ m ²	Vlera	Dokumenti i pronësisë
1	Bashkëpronarët Shkëmbi Cale	3819	1000/2	arë	31	100	3,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
2	Vrenos Mestan Shahinas	3819	994/2	arë	9	100	900	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
3	Donika Hasani, Përparim Hasani	3819	994/29	arë	24	100	2,400	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
4	Begator Mahmut Mukallari	3819	1003/1	arë	2	100	200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
5	Qemal Idriz Skënderi	3819	955/20	arë	12	100	1,200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
6	Jonuz Mersin Bezhani	3819	960/13	arë	400	100	40,000	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
7	Lefter Ilia Samara	3819	960/12	arë	165	100	16,500	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
8	Nastas Toli Grosi	3819	823/3	arë	11	100	1,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
9	Jani Thoma Bozda	3819	811/27	arë	21	100	2,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
10	Manastiri i Shën Prodhomit	3819	800	arë	53.4	100	5,340	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
11	Manastiri i Shën Prodhomit	3819	800/1	arë	632	100	63,200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
12	Gjergji Vasillaq Tërpo	3819	758/1	arë	15	100	1,500	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
13	Liljana Jorgji Tërpo	3819	759	arë	407	100	40,700	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
14	Edgar Stavro Frashëri	3819	954/9	arë	90	100	9,000	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
TOTALI					1872.4		187,240	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
1	Astrit Sulejman Bebri	3819	823/1	truall	53	211	11,183	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
TOTALI							198,423	

2. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE E PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “PARKU JAPONEZ DHE KOPSHTET E KOMUNITETIT”, BASHKIA KORÇË

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	ZK	Nr. i pas.	Statusi i pronës sipas ZVRPP	Sip. e truallit që shpron. (m ²)	Çmimi i truallit lekë/ m ²	Vlera e truallit	Dokumenti i pronësisë
1	Naum Gogo, Gjergji Gogo	8562	3/616	Truall	180.4	9055	1,633,522	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
TOTALI							1 633 522	

Shuma e përgjithshme për dy projektet është = 1 831 945